

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë

Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) dhe Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit, një hap i rëndësishëm në forcimin e lidhjeve mes institucioneve publike dhe botës akademike.

Dokumenti u nënshkrua nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi) dhe Rektori i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, z. Adrian Civici.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, për të edukuar brezat e ardhshëm të nëpunësve civilë dhe shprehu gadishmërinë për të ofruar trajnime dhe praktikë profesionale për studentët e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil risolli në vëmendje rolin e institucionit që drejton në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit “Për nëpunësin civil”, duke theksuar se marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë dhe me universitetet e tjera në vend do të ndihmojë në ndërtimin e një administrate publike profesionale, të qëndrueshme dhe të orientuar drejt standardeve më të mira evropiane.

Rektori i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Prof. Dr. Adrian Civici vlerësoi bashkëpunimin me Institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si një partner i rëndësishëm për shkëmbimin e ekspertizës në fushën e administrimit publik dhe një mundësi e artë për studentët, për të kryer praktikën profesionale dhe internship-in, pranë KMSHC-së.



Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit “KMSHC-Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” morën pjesë përfaqësues të Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe përfaqësues nga rektorati dhe dekanati i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.